



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 20, Datë 17.12.2024

"Për miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Sekretariatit Teknik, si dhe të ekspertëve dhe konsulentëve të jashtëm ndërkombëtarë"

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Rregullores së Kuvendit, si dhe në pikat VIII dhe X të vendimit Nr. 50/2024, datë 30.05.2024, të Kuvendit të Shqipërisë, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", në Vendimin Nr. 14, datë 26.07.2024, në Vendimin Nr. 16, datë 28.10.2024, dhe në Vendimin Nr. 17, Datë 28.10.2024 me propozim të Sekretariatit Teknik, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet dhe korrigjimet në përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe të Sekretariatit Teknik (ST), të miratuara me Vendimin Nr. 14, datë 26.07.2024 (i ndryshuar me Vendimin nr. 16, datë 28.10.2024), si dhe të listës së ekspertëve dhe konsulentëve të jashtëm ndërkombëtarë, të miratuar me Vendimin Nr. 17, Datë 28.10.2024, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ndryshimet e parashikuara në pikën 2 më sipër, të reflektohen në organigramën dhe strukturën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ